



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Inspektorati i Punës/Inspektorat Rada/Labour Inspectorate

Bazuar në nenin 94 të Ligjit Nr.03/L-121 i Punës , neni 24 të Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë , dispozitave të nenit 4 dhe nenit 6 të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës , Ligjit nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr.2002/9 , dispozitat e nenit 132 të Ligjit Nr.05/L-031 të LPPA dhe Aktgjykimit nr. K027/21 i dt. 16.12.2022 i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës Organi i Shkallës së Dytë në Inspektoratin e Punës në përbërje të : Hekuran Nikçi – Kryeinspektor dhe zyrtarët përgjegjës për zhvillimin e procedurës : Murat Vokshi dhe Florim Salihaj duke vendosur sipas ankesës dt.11/08/2023,e subjektit juridik Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare’’Dr. Vezir bajrami’’ Shtime e ushtruar kundër Vendimit Nr.355/2023 të dt. 08.08.2023 të organit të shkallës së parë ,organi i shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës marrin këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e palës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare’’Dr. Vezir bajrami’’ Shtime ushtruar kundër vendimit Nr.355/2023 të dt. 08.08.2023 i organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës.

VËRTETOHET Vendimi Nr.355/2023 të dt. 08.08.2023, i organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës.

A R S Y E T I M

Inspektorati i Punës në Ferizaj ,si Organ i shkallës së parë sipas detyrës zyrtare me dt.09.06.2023 në subjektin juridik Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare’’Dr.Vezir bajrami’’ Shtime ka realizuar vizite inspektuese të Rrahman Jakupi me datë 17.07.2023, inspektorja e punës ka hartuar raportin Zyrtar Nr.67/2023.dt. 28.02.2023 dhe pas përfundimit të procedurave ka nxjerr Vendimin Nr.355/2023 të dt. 08.08.2023,me të cilin i ka Subjekti QKMF - ‘’Dr. Vezir Bajrami’’,

me seli në Shtime rruga "Anton Çeta" me punëdhënës: Dr. Pranvera Bajrami, tekstin në vijim punëdhënësi/ja është përgjegjës/se për:

Mos zbatimin e dispozitave ligjore të neneve 8, 10,11 dhe 17 paragrafi 1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 të sanksionuar me nenin 92 paragrafi 1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dhe nenit 7 paragrafi 4 nënparagrafi 4.2, paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, paragrafi 2 nënparagrafi 2.7 i Udhëzimit Administrativ Nr.07/2012 për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, i shqiptohet gjobë në lartësi prej **Pesëqind Euro (500 €)**. Gjithsej i shqiptohet gjobë në lartësi prej Pesëqind Euro (500 €).

Punëdhënësi QKMF-"Dr. Vezir Bajrami", ne Shtime, duhet të dëshmoj pagesën e dënimit, duke dorëzuar një kopje të pagesës te Inspektorët e Punës, në të kundërtën do konsiderohet se nuk është bërë pagesa dhe do iniciohet procedura përmbareuese e inicimit me dhunë tek organet kompetente. Parashtruesi i ankesës Rrahman Jakupi, me datë 24.05.2023, në Inspektoratin e Punës Rajonin e Ferizajt ka dërguar ankesën përmes mjeteve elektronike-në emailin zyrtar tek Koordinatori Z.Arton Çekini, me pretendimet se: në QKMF "Dr.Vezir Bajrami" në Shtime, Drejtoresha Pranvera Bajrami ushtron pozitën e drejtorit pa përfillur dhe pa zbatuar procedurat e konkursit, pastaj pozitën udhëheqëse në këtë institucion ndryshohen me vendim nga drejtoresha Pranvera Bajrami pa përfillur kontratat e punës për të punësuarit Musë Baftiu-kryeinfermier I QKMF-së, Fahrije Maksuti-kryeinfermiere e shërbimit të Mjekësisë Familjare, Behxhet Hyseni-kryeinfermier i shërbimit të urgjencës, Osman Ismajli koordinatorë i SISH, dhe punësimi pa përfillur procedurat ligjore, Efendi Sahiti dhe Beqir Beqa.

Inspektorja e Punës duke vepruar sipas ankesës Nr.38/23 të pranuar me datë 25.05.2023, të ushtruar nga parashtruesi Rrahman Jakupi për vërtetësinë e pretendimeve ankimore me datë 09.06.2023, rreth orës 09:45h, bënë vizitë inspektuese dhe takohet me Kaltrina Beqa-zyrtare për personel në administratë, ku e njoftojmë me pretendimet ankimore të palës ankuese dhe obligon, të prezantoj dokumentacionin si në vijim: Konkursin publik për drejtorë --Pranvera Rexhepin. Kontratat e punës për kryeinfermierët, Musë Baftiu, Fahrije Maksuti, Behxhet Hyseni dhe Osman Ismajli.

Vendimet e emërimit të zyrtarëve në pozitën udhëheqëse, konkursin publik dhe kontratat e punës. Themelimin e marrëdhënies së punës për mjekët specialist dhe konkursin publik për Beqir Beqa dhe Efendi Sahiti.

Kontratën Nr.03/1/014 datës 20.04.2021.

Listën e pagave për të punësuarit Musë Baftiu, Fahrije Maksuti, Behxhet Hyseni, Osman Ismajli për muajt tetor nëntor 22 dhe muajt prill, maj 2023.

Inspektorja e Punës pas prezantimit të provave nga punëdhënësi dhe shqyrtimit të tyre ka hartuar Raport Zyrtar Nr.294/23 me datë 07.07.2023 konstatoi se:

Punëdhënësi QKMF "Dr.Vezir Bajrami" në Shtime, ka të punësuar Dr.Pranvera Bajrami në pozitën e drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr.Vezir Bajrami" në Shtime, është emëruar vetëm me Vendimin Nr.02/02 të datës 11.01.2022, sipas të cilit vendim znj.Pranvera Bajrami caktohet Ushtrues i Detyrës Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Vezir Bajrami" ne Shtime, dhe në këtë rast punëdhënësi QKMF-Shtime nuk ka përfillë procedurën e themelimit të marrëdhënies së punës për drejtor të QKMF-së në Shtime, pra nuk ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sipas të cilit **citon**: punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik kur pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.

Sektorin Publik, i cili duhet të shpallë konkurs publik (ose të brendshëm) për plotësimin e vendit të Shefit të Shërbimit të Mjekësisë Familjare në QKMF-Shtime.

Organit të shkallës së dytë IP-së, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës të prezantuara dhe vendimin e shkallës parë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesën e palës në procedurë gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Organi i shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës ka bërë vlerësimin e provave dhe fakteve ;Raportin Zyrtar Nr.261/2023.dt. 09.06.2023,ankesës dt.Nr.363/2023, dt..11.08.2023,vendime tjera, dëshmi e pagave. Me raportin zyrtar Raportin Zyrtar Nr.261/2023.dt. 09.06.2023 pas përfundimit të kontrollës inspektuese në subjektin juridik ju është dhënë afati për eliminimin e parregullsive edhe pas kalimit të afatit nuk është njoftuar inspektorati për eliminimeve të parregullsive .

Organi i Shkallës së dytë , shqyrtoj pretendimet ankimore të palës në procedurë subjektin juridik Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare''Dr.Vezir bajrami'' Shtime dhe dokumentacionin e ofruar dhe konstatoi se Nr.355/2023 të dt. 08.08.2023,i organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës është marrë në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative Vendimi i kundërshtuar me ankesë është juridikisht i qarte, po ashtu edhe arsyetimi i vendimit pasqyron qarte aplikimin e dispozitave ligjore në rastin konkret nga inspektori i lëndës.

Duke u bazuar në dispozita të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës , Ligjit nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr.2002/9 konkretisht nëni 2 paragrafi 1 ;Neni 2 Funksionet e Inspektoratit të punës 2. Inspektorati i punës: a) Do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë. Ligji Nr.03/L – 017 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2002/9 Inspektoratit të Punës Në pikën (c) paragrafi 5 i nenit 5 riformulohet si vijon:

“ Shënojnë me anë të raportit zyrtar , mos respektimin apo shkeljen e dispozitave ligjore.

Inspektori i punës me vendim shqipton gjobën”.


Për arsyet e cekura më lartë Organi i shkallës së dytë i IP-së gjeti se në vendimin e kundërshtuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj pretendimet ankimore të ushtruara nga pala në procedurë janë jo bindëse dhe si të tilla refuzohen. Sepse bëjnë një arsyetim jo bindës për konstatimin e gjendjes faktike dhe aplikimin e dispozitave ligjore, sepse të gjitha faktet që i përshkruan në ankesë dhe i kanë sjellë me ankesë janë fakte që i janë shqyrtuar në këtë procedurë edhe nga Organi i Shkallës së parë të Inspektoratit të Punës, fakte të cilat i shqyrtoi edhe Komisioni i Organit të shkallës së dytë dhe vlerësoi se inspektori i punës drejtë ka konstatuar gjendjen faktike, drejtë ka aplikuar dispozitat ligjore, drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat i aprovoi edhe Organi i Shkallës së Dytë i IP-së .

Pretendimet ankimore të ushtruara nga pala në procedurë janë jo bindëse të pa vërtetuara me prova prandaj edhe Organi i Shkallës së dytë vendosi që ta refuzoj ankesën si të pa bazuar dhe ta vërtetoj Vendim r.355/2023 të dt. 08.08.2023,i organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës. Organi i Sh s së dytë i Inspektoratit të Punës gjeti se në vendimin e atakuar gjendja

faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë , ndërsa pretendimet ankimore të ushtruara nga pala në procedurë janë jo bindëse të pa vërtetuara me prova prandaj edhe Organi i Shkallës së dytë vendosi që ta refuzoj ankesën si të pa bazuara dhe ta vërtetoj Vendimin Nr.355/2023 të dt. 08.08.2023,i organit të shkallës së parë të Inspektorit të Punës .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës
Hekuran Nikçi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi mund të ngritët kontesti administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet;

1x2 ekzemplarë palëve në procedurë,

1x2 Inspektoratit të Punës.